



Fija e kujdesit

Një ditë në jetën e një përkujdesëse

Fllanza Nici, 44, instruktore e jogës



Si duket kujdesi në çastet e vogla të përditshmërisë

Që nga momenti kur zgjohemi në mëngjes, e madje edhe kur jemi në gjumë, diabeti është gjithmonë me ne. Tani është shumë ndryshe nga koha kur Lisa ka qenë e vogël dhe më duhej të bëja gjithçka për të. Në atë kohe, gjëja e parë që bëja ishte t'ia kontrolloja sheqerin në gjak, pastaj t'ia përgatisja mëngjesin dhe të llogaritja karbohidratet për çdo shujtë të ditës. Çdo pjesë e ditës kërkon vëmendje.

Atëherë shpesh ndihesha sikur unë duhej të isha pankreasi i saj. Gjithmonë mendoja përpara, për ushqimin, insulinën, shkollën, aktivitetet. Duke u munduar që gjithçka të ishte në balancë që ajo të ishte mirë dhe e sigurt. Janë momente të vogla të përditshme, por me përgjegjësi shumë të madhe.

Lisa tani menaxhon diabetin vetë, por u deshën shumë vite udhëzimi dhe mbështetje për ta bërë të pavarur deri në këtë pikë.





Kur Lisa u diagnostikua, ka qenë një periudhë shumë e vështirë për familjen tonë. Djali im ishte vetëm gjashtë muajsh dhe unë isha në pushim të lehonisë. Burri im është kujdesur shumë për gjendjen shëndetësore të Lisës dhe ka qenë vazhdimisht pranë saj, duke u siguruar që të kishte trajtimin dhe përkujdesjen e nevojshme. Megjithatë, për të qenë plotësisht e sigurt dhe për të pasur kujdes maksimal ndaj saj dhe familjes, vendosa të qëndroj në shtëpi dhe t'i përkushtohem plotësisht kësaj situatë.

Në atë kohë nuk kishim sensorë të glukozës apo pompa insuline si sot. Gjithçka duhej kontrolluar manualisht. Gjatë ditës merreshim me menaxhimin e diabetit të saj, ndërsa gjatë natës vendosja alarme çdo dy ose tre orë që të zgjohesha dhe t'ia kontrolloja sheqerin në gjak.

Shume netë kalonin pa gjumë, por ishte e domosdoshme që ajo të ishte e sigurt. Asnjë nënë nuk është e përgatitur plotësisht për diçka të tillë, por mëson me kohë. Me dashuri dhe edhe me frikë në të njëjtën kohë. Në fund, bën gjithçka që mundesh për ta mbajtur fëmijën tënd të sigurt.

Do të doja që publiku të kuptonte se familjet që jetojnë me sëmundje kronike bartin një përgjegjësi që shpesh nuk shihet. Nuk është vetëm personi me diabet ai që përballët me sfida, e gjithë familja përshtatet, planifikon dhe shqetësohet çdo ditë. Ka netë pa gjumë, monitorim të vazhdueshëm dhe stres emocional që vjen nga dëshira për ta mbajtur fëmijun tuaj të sigurt dhe të shëndetshëm. Kjo kërkon durim, qëndrueshmëri dhe punë në ekip. Ndonjëherë mund të ndihet izolues sepse të tjerët nuk e shohin gjithmonë përpjekjen. Ajo që familjet kanë më shumë nevojë është mirëkuptim, mbështetje dhe dhembshuri nga njerëzit përreth.



Ajo që njerëzit shpesh nuk e shohin është sa serioze është kjo gjendje. Si nënë, papritmas duhet të marrësh rolin e një organi që nuk funksionon më në trupin e fëmijës tënd. Në shumë mënyra, unë duhej të bëhesha pankreasi i Lisës. Ta dish që jeta e fëmijës tënd varet nga vendimet që merr ti çdo ditë, është shumë e frikshme.

Nënat shpesh ndihen shumë të mbingarkuara nga kjo përgjegjësi. Nganjëherë njerëzit edhe gjykojnë, duke menduar se një nënë nuk po kujdeset sa duhet për fëmijën e saj, por nuk e shohin presionin e vazhdueshëm që është prapa. Ne thjesht po bëjmë më të mirën tonë çdo ditë.

Shumë shpesh nënat ndalojnë edhe së kujdesuri për veten, sepse gjithë energjia shkon te fëmija. Kjo është një përgjegjësi që nuk ndalet kurre, është aty 24 orë. Edhe tani që Lisa është rritur, unë ende shqetësohem për të vazhdimisht.